

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pesë të arrestuar pranë bazës RAF Fairford në Britani, hetohen për një sulm të mundshëm terrorist
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/pese-te-arrestuar-prane-bazes-raf-fairford-ne-britani-hetoh-en-per-nje-sulm-te-mundshem-terrorist/1031169/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 14:37:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 14:34:34 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a24bd6af0828fa46f996f2cfba4bfdbf86c7ef099ccb4421a66fbc66185a4744
TEKSTI	d89eb708a472ba18b68dc0740e473b2915e9ee78ab27c61551c9c50d8ff95274
PAMJA	ced4cb622d79e54d0ec270c760870fff38eac4baa0208fdb571b520599df521a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	36cbd72b3b9135892f64ba614d1ccd69e0ebf87b4345722ce520836a40e66ec7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/36cbd72b3b9135892f64ba614d1ccd69e0ebf87b4345722ce520836a40e66ec7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Pesë të arrestuar pranë bazës RAF Fairford në Britani, hetohen për një sulm të mundshëm terrorist



Pesë burra britanikë, të moshave 23 deri në 25 vjeç, janë vënë në pranga pranë bazës ajrore RAF Fairford, në Gloucestershire, ndërsa autoritetet po hetojnë dyshimet për përgatitjen e një sulmi terrorist.

Komanda Britanike Kundër Terrorizmit bëri të ditur të hënën se të arrestuarit janë shtetas britanikë dhe se vazhdojnë të qëndrojnë në paraburgim. Hetuesit po shqyrtojnë provat e sekuestruara në tre automjete të dyshimta të gjetura pranë bazës.

Sipas të dhënave të autoriteteve, tre prej tyre janë banorë të Westminsterit, një i Camdenit dhe një tjetër i Willesdenit, në Londër.

Arrestimet e para u kryen mbi bazën e ligjeve që lidhen me eksplozivët, por më vonë të dyshuarit u arrestuan sërisht nën dyshimin se po përgatitnin një akt terrorist. Legjislacioni britanik kundër terrorizmit u lejon autoritetet t'i mbajnë ata në paraburgim për një periudhë deri në 14 ditë pa ngritur akuza.

Ngjarja u sinjalizua në orët e para të së dielës, kur banorë të zonës raportuan lëvizjen e tre automjeteve të dyshimta në drejtim të RAF Fairford.

Telefonata e parë në numrin 999 u regjistrua rreth orës 00:45. Pas njoftimit, oficerë të armatosur mbërritën në Welford, pranë bazës, dhe arrestuan pesë personat.

Autoritetet ndërmorën më pas një operacion të gjerë kontrolli. Ekipet e çaktivizimit të bombave të Ushtrisë Britanike inspektuan tre furgonë të bardhë, duke përdorur edhe një robot të komanduar në distancë.

Si masë sigurie, rreth 85 banesa u evakuuan dhe u krijua një perimetër ndalimi me shtrirje prej disa qindra

të fundit /



Video/ Sulmi me dron rus përfshin nga zjarri Akademisë e...



Pas ndarjes, Kerry Adams mori dorezat e kuzhinës, hodhi të...



U largua nga puna pas natës në saunë, tani kërkon deri në 76...



Kosova përballet sërish me Izraelin pas afro tre vjetësh, me katër pik...



Salianji: PD-ja duhet të mobilizojë qytetarët, Berisha po bëhet...



Ushtarët britanikë të forcës rezervë strategjike të KFOR-it...



Real Madridi vëzhgon nga afër të ardhmen e Alexis Mac Allister te...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

metrasn.

The Guardian raportoi se hetuesit po analizojnë materialet e gjetura në automjete. Vlerësimet e para ngrenë dyshimin se ato mund të lidhen me pajisje shpërthyes të improvizuara, por procesi i ekzaminimit ende nuk ka përfunduar.

Një nga objektivat kryesore të hetimit është të përcaktohet motivi i të arrestuarve dhe nëse ata kanë vepruar në interes të një fuqie të huaj apo të një organizate tjetër.

Raportimet e mediave britanike kanë përmendur edhe një lidhje të mundshme me Iranin. Megjithatë, autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar nuk e kanë lidhur zyrtarisht çështjen me Teheranin dhe nuk kanë thënë se të dyshuarit vepronin në emër të shtetit iranian.

Ambasada iraniane në Londër ka mohuar në mënyrë kategorike çdo përfshirje. Ajo i ka cilësuar raportet si "spekulime të pabaza dhe keqdashëse", duke pretenduar se ato nxisin kultivimin e "iranofobisë" në Britani.

Baza RAF Fairford konsiderohet me rëndësi strategjike, pasi përdoret nga Forcat Ajrore të SHBA-së dhe ka qenë e angazhuar si pikë operimi për bombarduesit amerikanë në misione të lidhura me luftën me Iranin.

Vicky Evans, Zëvendës Ndhmës Komisionerja dhe drejtuesja e Departamentit Britanik të Kundër-Terrorizmit, e cilësoi ndërhyrjen si një operacion "jashtëzakonisht kompleks dhe në shkallë të gjerë".

Në aksion u angazhuan struktura të policisë lokale e kombëtare, Ministria e Mbrojtjes dhe agjenci të tjera.

Policia tha se kontrollet dhe kërkimet e zhvilluara gjatë natës kanë nxjerrë pista të reja hetimi. Ndërkohë, masat e sigurisë dhe bllokada përreth RAF Fairford vijuan edhe gjatë së hënës.

Evans u kërkoi qytetarëve të mos nxjerrin përfundime apo të përhapin spekulime rreth motivit të të arrestuarve dhe dimensionit gjeopolitik të çështjes, pasi hetimet janë ende në vazhdim.

Një grua që jeton në zonë duket se ka ndihmuar në vënien në lëvizje të autoriteteve. Ajo po kthehej në banesë në orët e para të mëngjesit, kur pa tre furgonët që kishin zënë rrugën pranë bazës.

Ajo telefonoi numrin 999 dhe njoftoi se kishte parë disa burra duke u larguar nga automjetet në drejtime të ndryshme. Gruaja ka thënë se ishte e habitur që njoftimi i saj shkaktoi alarmimin e autoriteteve, ndërsa pretendoi se policia ende nuk e kishte marrë në pyetje në mënyrë të detajuar.

Sekretari i Mbrojtjes Wes Streeting e përgëzoi reagimin e saj, duke deklaruar se ajo "bëri pikërisht atë që ne do të shpresonim se dikush do të bënte në një situatë si kjo". Megjithatë, ai shtoi se gruaja kishte vetëm një "pamje të pjesshme" të ngjarjes.

Presidenti amerikan Donald Trump tha se agjencitë amerikane dhe britanike "i njihnin" të dyshuarit dhe pretendoi se ata po përgatiteshin të shkaktonin "dëme të mëdha".

Ky version nuk është konfirmuar nga autoritetet britanike. Sipas të dhënave paraprake, ndërhyrja policore nisi pas telefonatave të banorëve dhe jo si pjesë e një operacioni të planifikuar nga shërbimet e inteligjencës.

Shtuar më 28.09.2026 16:34



Video/ Sulmi me dron rus përfshin nga zjarri Akademinë e Shkencave...



Infermierja dëshmon për vdekjen e George Mazonakis: Mjeku u tha...



Papa Leoni kundërshton rritjen e buxheteve ushtarake në Europë:...



Trump pyeti Xi nëse Kina do të blinte armë amerikane, Departamenti...



Andersson heq dorë nga përpjekja për qeverinë suedeze pas qëndrimit të...



Fermeri alarmoi policinë për burrat e maskuar pranë bazës amerikane:...



Kallas paralajmëron për sabotime të reja ruse në Europë dhe kërkon më...



Rreziku po shtohet"/ Shërbimi danez i inteligjencës paralajmëro...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.